

Titulli i lëndës: NORMA E SHQIPES SË FOLUR

Informatat themelore për lëndën																	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Dega e Gjuhës Shqipe																
Titulli i lëndës:	Norma e shqipes së folur																
Niveli:	BA (Baçelor)																
Statusi i lëndës:	Obligative																
Viti i studimeve:	Viti I Semestri II																
Numri i orëve në javë:	2+4																
Kreditë ECTS:	6 ECTS																
Orari i mësimit:	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Dita</th> <th>Ora</th> <th>Salla</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td rowspan="2">Ligjëratat</td> <td>E enjte</td> <td>10:30-12:00</td> <td rowspan="2">76</td> </tr> <tr> <td>E martë</td> <td>11:00-12:00</td> </tr> <tr> <td rowspan="2">Konsultimet</td> <td>E mërkurë</td> <td>13:30-14:30</td> <td rowspan="2">68</td> </tr> <tr> <td>E enjte</td> <td>12:00-13:00</td> </tr> </tbody> </table>		Dita	Ora	Salla	Ligjëratat	E enjte	10:30-12:00	76	E martë	11:00-12:00	Konsultimet	E mërkurë	13:30-14:30	68	E enjte	12:00-13:00
	Dita	Ora	Salla														
Ligjëratat	E enjte	10:30-12:00	76														
	E martë	11:00-12:00															
Konsultimet	E mërkurë	13:30-14:30	68														
	E enjte	12:00-13:00															
Mësimdhënësi:	Prof. Asoc. Dr. Shpëtim Elezi																
Të dhënat kontaktuese:	shpetim.elezi@uni-pr.edu																
Përshkrimi i lëndës:	Kursi <i>Norma e shqipes së folur</i> ofron bazën teorike e praktike të normës shqiptimore të shqipes standarde dhe të elementeve prozodike të saj. Ky kurs u ofron studentëve shpjegimet dhe sqarimet e nevojshme teorike lidhur me përvetësimin dhe aplikimin e rregullave të drejtshqiptimit të gjuhës standarde shqipe. Ligjërimi me gojë është i nevojshëm për të gjithë për nevoja akademike dhe profesionale, andaj për të folur korrekt dhe pa gabime drejtshqiptimore është e domosdoshme që të mësohen parimet dhe rregullat ortoepike të shqipes standarde, që para së gjithash janë të natyrës fonetike. Kursi përfshin edhe elemente mbisegmentare, siç janë theksi, rrokja, intonacioni, pauzat, ritmi etj.																
Qëllimet e lëndës:	Ky kurs synon të zhvillojë kompetencën teorike dhe praktike në përdorimin e shqipes standarde në të folur. Qëllimi është që të ngrihen niveli dhe kultura e të shprehurit me gojë në domene e situata formale të komunikimit publik. Lidhur me këtë kurs përfshin parimet dhe rregullat ortoepike të normës së folur të shqipes standarde, si dhe dijen mbi elementet prozodike të të folurit për nevoja akademike e profesionale në komunikimin publik. Po ashtu kursi ka për qëllim që studenti të arrijë të identifikojë e të shpjegojë parimet dhe rregullat ortoepike të shqipes standarde.																
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studenti:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shqipton rrjedhshëm dhe pa gabime në përputhje me rregullat ortoepike dhe prozodike (mbisegmentale) të shqipes standarde gjatë komunikimit gojor në situata formale. • Identifikon gabimet dhe shmangiet nga norma e folur në domenet dhe situatat e komunikimit formal. • Shpjegon rregullat e normës së shqipes së folur. • Dallon shqiptimin normativ nga ai jonormativ të tingujve të shqipes standarde, duke mënjanuar variantet e shqiptimit jostandard në komunikimin formal. • Analizon rregullat duke u bazuar në parimet e normës së shqipes së folur. 																

- Heton faktorët gjuhësorë e jashtëgjuhësorë që kanë ndikim në zbatim të normës së shqipes së folur.
- Rekomandon lidhur me rregullat ortoepike të shqipes standarde.

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë / Javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	22.5
Ushtrime	4	15	45
Përgatitje për test intermediar	3	4	12
Konsultime me mësimdhënësin	10 min	15	2.5
Testi, punimi i seminarit	2	2	4
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	3	4	12
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	10 min	15	2.5
Totali			149.5 orë 149.5:25=5.98 6 ECTS

Metodat e mësimdhënies: Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave që ofrojnë bazën teorike dhe ushtrimeve që ofrojnë bazën praktike në klasë si dhe me detyra të vazhdueshme në shtëpi. Mësimdhënia gjatë ligjëratave do të jetë e organizuar nëpërmjet një diskutimi interaktiv për tema të caktuara. Gjatë ushtrimeve mësimdhënia është e orientuar nga studentët, ndërsa mësimdhënësi e kontrollon rrjedhën e orës dhe të shpjegimit të koncepteve të diskutueshme e të paqarta. Studentët kanë detyra, punime seminarit e punime të tjera me shkrim, të kryera në mënyrë të pavarur e individuale, por bëjnë edhe punë në çifte e në grupe, si edhe hulumtime. Përmes projekteve e prezantimeve nxiten debate e diskutime. Studentët gjithashtu ndjekin programe radiofonike e televizive, filma dhe shfaqje teatrale dhe diskutojnë rreth tyre.

Metodat e vlerësimit: Ka dy mënyra të vlerësimit: vlerësimi i vazhdueshëm dhe vlerësimi përfundimtar.

a) Në kuadër të vlerësimit të vazhdueshëm aplikohen disa metoda vlerësimi:

Metodat e vlerësimit	Përqindja
1. Pjesëmarrja aktive (L+U)	10%
2. Detyrat individuale (U)	10%
3. Punim seminarit (studim rasti)	10%
4. Prezantimi	10%
5. Kolokuiumi I	20%
6. Kolokuiumi II	20%
7. Të pyeturit me gojë	20%
Totali	100%

Kolokuiumi I mbahet në javën e 7-të (më 2.4.2026) dhe *kolokuiumi II* në javën e 15-të (më 28.5.2026).

Temat e punimeve të seminarit caktohen në javën e 2-të dhe dorëzohen

	<p>në javën e 11-të në formë elektronike në e-mailin zyrtar. Vërejtjet lidhur me detyrat dhe punimet jepen gjatë orarit të konsultimeve. Prezantimi i hulumtimeve bëhet në javën e 14-të. Vërejtjet lidhur me detyrat dhe punimet jepen gjatë orarit të konsultimeve.</p> <p>Pikët e akumuluar nga mjetet e lartcekura të vlerësimit sipas përqindjes së caktuar evidentohen në modulën e <i>vlerësimit të vazhdueshëm</i> në SEMS.</p> <p>b) Vlerësimi përfundimtar organizohet me shkrim dhe me gojë. Kjo mënyrë vlerësimi aplikohet në rastet kur nuk arrihet sukses me anë të vlerësimit të vazhdueshëm.</p> <p>Shënim 1. Pragu i kalueshmërisë është 50%: 51 – 60% (nota 6), 61 – 70 (7), 71 – 80 (8), 81 – 90 (9), 91 – 100 (10).</p> <p>Shënim 2. Për shkak të natyrës specifike të lëndës, si në kuadër të <i>vlerësimit të vazhdueshëm</i>, ashtu dhe në kuadër të <i>vlerësimit përfundimtar</i> aplikohet të pyeturit me gojë për t'u testuar kështu aspekti praktik i zbatimit të normës së shqipes së folur.</p>
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shpëtim Elezi, Norma e shqipes së shkruar. Prishtinë: Albas, 2025. 2. Bardh Rugova, Leksikon i termave të fonetikës dhe të fonologjisë. Prishtinë: ASHAK, 2019. 3. Anastas Dodi, Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe. Tiranë, 2004. 4. Bahri Beci, Fonetika. Prishtinë, 2004. 5. Drejtshkrimi i gjuhës shqipe. Tiranë: ASHSH, 1973.
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ali Dhrimo – Rami Memushaj, Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe, Tiranë: Infobotues, 2011. 2. Anastas Dodi, Drejtshkrimi dhe shqiptimi letrar. Kongresi i Drejtshkrimit, vëll. I, Tiranë, 1973. 3. Anastas Dodi, Gjuha e folur letrare dhe norma e saj fonetike në etapën e sotme. Gjuha jonë, nr. 2, Tiranë, 1985. 4. Anastas Dodi, Kultura e gjuhës dhe shqiptimi letrar. Gjuha jonë, Tiranë, 1981. 5. Anastas Dodi, Ndarja aktuale e fjalisë dhe intonacioni në gjuhën shqipe. Gjuha jonë, nr. 4, Tiranë, 1986. 6. Anastas Dodi, Rreth problemeve të drejtshqiptimit të gjuhës letrare shqipe. Studime filologjike, nr. 4, Tiranë, 1972. 7. Anastas Dodi, Fusha e shpërndarjes së zanoreve dhe problemet e normës së shqiptimit. Gjuha jonë, nr. 1-4, Tiranë, 1986. 8. Eqrem Çabej, Diftongje e grupe zanoresh të shqipes. BUSHT, SSHSH, 3, 1958, Tiranë. 9. Fadil Sulejmani, Praktikum i gjuhës shqipe, Prishtinë, 1981. 10. Fjalor i madh i gjuhës shqipe, Tiranë: ASHSH, 2006. Shih në: https://fjalori.online/ 11. Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe. Tiranë: ASHSH, 1976. 12. Flutura Çitaku, Disa shmangie nga norma e gjuhës letrare në emisionet e Radio Tiranës. Konferenca shkencore “Gjuha letrare kombëtare sot”, Tiranë, 1992 (Tiranë, 2002) dhe në “Gjuha jonë”, 1/4, Tiranë, 1993. 13. Flutura Çitaku, Gjuha e RTK-së. Seminari 19. Prishtinë, 2000. 14. Flutura Çitaku, Ligjërimi i komentatorëve të Botërorit “Gjermania 2006”, Seminari 25/1, Prishtinë, 2006. 15. G. Bevington, Albanian Phonology, Chicago, 1973. 16. G. Bevington, Albanische Betonung im Lichte der generative Phonologie, Innsbruck, 1977. 17. Gramatika e gjuhës shqipe, 1, 2, Tiranë: ASHSH, 2002. 18. Gjovalin Shkurtaj, Kultura e gjuhës. Tiranë, 2006.

19. Gjovalin Shkurtaj, Kultura e gjuhës në skenë dhe në ekran. Tiranë, 1988.
20. Gjovalin Shkurtaj, Ta duam dhe ta mbrojmë gjuhën tonë të bukur. Tiranë, 1998.
21. Gjuha jonë (revistë e botuar nga IGJL në Tiranë).
22. Gjuha letrare shqipe për të gjithë, Tiranë, 1976.
23. Gjuha shqipe (revistë e botuar nga IA në Prishtinë).
24. Isa Bajçinca, Shqipja standarde dhe probleme rreth saj. Prishtinë, 2016.
25. Kolec Topalli, Theksi në gjuhën shqipe. Tiranë, 1995.
26. Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Tiranë: ASHSH, 1973.
27. Lumnie Boriqi, Intonacioni dhe funksionet e tij në gjuhën shqipe. Studime filologjike, nr. 2, Tiranë, 1987.
28. Për pastërtinë e gjuhës shqipe, Tiranë: ASHRSH, 1998.
29. Rami Memushaj, Shqipja standarde – Si ta flasim dhe ta shkruajmë. Tiranë, 2004.
30. Rami Memushaj, Vendi i drejtshkrimit dhe i drejtshqiptimit në normat e gjuhës letrare. Gjuha jonë, Tiranë, 1984/1.
31. Rregullat e drejtshkrimit të shqipes (Projekt). Prishtinë: UP, 1967.
32. Zijadin Munishi, Gjuha shqipe dhe kultura e të shprehurit. Prishtinë, 1984.

Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Përshkrimi i silabusit. Hyrje në normë të shqipes së folur
Java 2:	Norma e shqipes së folur. Parime dhe rregulla
Java 3:	Rruga dhe faktorët e zhvillimit të normës drejtshqiptimore. Baza dialektore fonetike e normës së shqipes së folur
Java 4:	Rregullat e drejtshqiptimit. Zanoret gojore. Seria e zanoreve hundore. Drejtshqiptimi i zanoreve dhe i togjeve të zanoreve. Shqiptimi i zanoreve të patheksuara. Shqiptimi i ë-së së patheksuar
Java 5:	Shqiptimi i bashkëtingëlloreve dhe i grupeve të bashkëtingëlloreve
Java 6:	Shkaqet e shmangies nga shqiptimi standard: Shprehitë dhe veçoritë dialektore të shqiptimit të folësit. Shqiptimi <i>shkronjë për shkronjë</i> i fjalëve të gjuhës së shkruar (ndikimi i shkrimit në shqiptim)
Java 7:	Shkaqet e shmangies nga shqiptimi standard: Shprehitë individuale të shqiptimit. Shqiptimi i shkujdesur. Ndikimi i shqiptimit të gjuhëve të huaja (<i>KOLOKUIUMI 1</i>)
Java 8:	Stilet e shqiptimit: neutral, bisedor, solemn
Java 9:	Prozodia dhe njësitë prozodike (mbisegmentare): theksi, intonacioni, tonet, ritmi, kuantiteti. Ndarja e rrjedhës së ligjëritimit. Njësitë e rrjedhës së ligjëritimit: fraza, sintagma, fjala. Shënuesit ndarës të rrjedhës së ligjëritimit: synimi i folësit, stili dhe shpejtësia e të folurit, lidhja kuptimore e fjalëve, konturi melodik, intonacioni, pauzat, spikatja e fjalëve të veçanta, toni, rendi i fjalëve, mjete leksikore, trajta e shquar dhe e pashquar
Java 10:	Rrokja. Ndarja fonetike e fjalëve në rrokje. Shqiptimi rrokjesor
Java 11:	Theksi i fjalës në gjuhën shqipe. Parametrat dhe funksioni i theksit. Vendi dhe natyra theksore e fjalëve të shqipes. Palëvizshmëria e theksit në gjuhën shqipe (<i>DORËZIMI I SEMINAREVE</i>)
Java 12:	Fjalët e theksuara (tonike). Fjalët e patheksuara (atone). Fjalët proklitike dhe enklitike. Fjalët me theks dytësor. Prapashtesa të theksuara dhe të patheksuara

Java 13:	Theksi sintagmatik. Theksi i fjalisë. Theksi logjik. Theksi emocional
Java 14:	Intonacioni në gjuhën shqipe. Komponentet dhe funksionet gjuhësore të intonacionit (<i>PREZANTIMET</i>)
Java 15:	Veçori të shqiptimit të fjalëve të huazuara relativisht vonë (<i>KOLOKUIUMI 2</i>)

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime është e detyrueshme sipas përqindjes së përcaktuar në *Rregulloren për studimet themelore-Bachelor*, nr. 22, të datës 13.1.2022. Sipas saj, studenti është i obliguar të ndjekë të paktën 75% të ligjëratave dhe të ushtrimeve, që në praktikë nënkupton minimumi **12 javë vijueshmëri** nga 15. Lejohen deri në **3 javë mungesë** pa e rrezikuar të drejtën e pjesëmarrjes në vlerësim.

Ushtrimet, si pjesë integrale e kursit, kryhen në përputhje me përmbajtjen e leksioneve, për të lehtësuar përvetësimin e përmbajtjes së temës së trajtuar.

Detyrat dhe aktivitetet e specifikuar më sipër janë të detyrueshme si pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Në orët e ushtrimeve rishikohen detyrat javore dhe monitorohet procesi i realizimit të kërkimit.

Gjatë orëve të mësimi lejohet dhe inkurajohet përdorimi i pajisjeve mobile dhe i platformave online në përputhje me qëllimet e kursit. Me rastin e hartimit të punimeve dhe prezantimeve semestrale, studentët inkurajohen të përdorin aplikacione kompjuterike.

Në komunikim me studentët dhe gjatë gjithë procesit të aktiviteteve akademike do t'u kushtohet rëndësi parimeve të përcaktuara në *Kodin e etikës për personelin akademik të UP-së*, nr. 1/868, të datës 24.7.2025.

Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim u nënshtrohen masave disiplinore në përputhje me rregulloret e UP-së.